

## STATUTI

### I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“ORHER” SH.P.K.

#### KAPITULLI I

#### EMËRTIMI, FORMA, OBJEKTI I VEPRIMTARISË, SELIA, KOHËZGJATJA

##### NENI 1

#### EMËRTIMI DHE FORMA E SHOQËRISË

**1.1 Shoqëria “ORHER” SHPK**, është e organizuar si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar dhe përbëhet nga ortakët e mëposhtëm:

1. Z. Mirel Mjekra I biri Kujtimit, lindur në datë 31.10.1988 në Tiranë e me banim në Tiranë, madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtësi i lehtënjofimit me numër personal I81031048M,
2. Znj. Sara Korreshi, e bija e Besnikut, lindur në datë 22.09.1997 në Lushnje e me banim në Tiranë, madhore me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtëse e lehtënjofimit me numër personal J75922054A


**1.2** Emërtimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është **“ORHER” SHPK**.

##### NENI 2

#### BAZA LIGJORE

**2.1** Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” i ndryshuar, si dhe të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë pozitën juridike të veprimtarisë private.

**2.2** Kjo shoqëri fiton zotësinë për të vepruar me regjistrimin e saj në regjistrin tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.



### NENI 3 OBJEKTI

#### 3.1 Objekti i aktivitetit të kësaj shoqërie është:

Thyerja e gurit dhenja e formes dhe finicioni; Ndertimi i larte dhe ndertimi i ulet Ndërtime civile dhe industrial;Ngritja dhe mbulimi i konstruksioneve te kulmeve; Ndertimi i autostradave,rrugeve,aeropoarteve dhe objekteve sportive;Germime; Punime te tjera te specializuara te ndertimit,vendosja e instalimeve te kanalizimit te ujrave te zeza dhe te bardha dhe atmosferike; Vendosja e instalimeve elektrike; Vendosja e izolatoreve etj. Transportim I mbetjeve urbane, inerteve etj.Grumbullim, perpunim dhe shitje skrapi te ndryshme. Pastrimin e ambienteve te brendshme dhe te jashtme dhe sistemim-gjelberim. Riparim i mjeteve motorike (servis). Tregtim automjetesh, pjeseve motorike.. Mirembajtje rutine dimerore rruges. Tregtim i pajisjeve, mallrave te ndryshme higjeno sanitare.

### NENI 4 SELIA

#### 4.1 Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga Asim Vokshi, Kompleksi USLUGA, pallati nr.53,hyrja 3 apartamenti 4 njësia administrative nr. 9 Tiranë.

### NENI 5 KOHEZGJATJA

#### 5.1 Shoqëria ka një kohëzgjatje të pacaktuar. Ajo mund të përfundojë veprimtarinë përpara këtij afati në rastet e prishjes, falimentimit ose të likuidimit të shoqërisë të parashikuara këto në legjislacionin tregtar shqiptar në fuqi.

## KAPITULLI II KAPITALI THEMELTAR DHE KUOTAT

### NENI 6 KAPITALI THEMELTAR

#### 6.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 200,000 (dyqind mijë) Lekë i ndarë në 2 (dy) kuota. Çdo kuotë njësi jep të drejtën e një vote. Kapitali themeltar i shoqërisë nënshkruhet tërësisht nga Ortakët.

#### 6.2 Pjesët e kapitalit të shoqërisë zotërohen nga Ortakët, si më poshtë vijon:

- **Ortaku Mirel Mjekra**, zotëron 1 (një) kuotë, të barabartë me 50% (pesëdhjetë) të kapitalit themeltar.
- **Ortaku Sara Korrreshi**, zotëron 1 (një) kuotë, të barabartë me 50% (pesëdhjetë) të kapitalit themeltar.



**NENI 7**  
**TRANSFERIMI I PJESËVE TË KAPITALIT THEMELTAR**

- 7.1 Pjesët e kapitalit themeltar mund të transferohen vetëm me akt noterial, nëpërmjet:
- a) shitblerjes;
  - b) trashëgimisë;
  - c) dhurimit;
  - d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.
- 7.2 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.
- 7.3 Pjesët e kapitalit mund t'u transferohen edhe të tretëve, por pasi të jetë ushtruar dhe refuzuar e drejta e parablerjes nga ortakët e shoqërisë dhe këta të kenë hequr dorë shprehimisht nga kjo e drejtë.

**NENI 8**  
**ZMADHIMI/ZVOGËLIMI I KAPITALIT THEMELTAR**

- 8.1 Ortakët/ortaku nuk kufizohen në rritjen e kapitalit themeltar. Zvogëlimi i kapitalit themeltar bëhet nga Ortakët/ortaku deri në kufijtë e parashikuar nga ligji.
- 8.2 Raporti i zmadhimit ose zvogëlimit të kapitalit miratohet në mënyrë të shprehur nga shumica e ortakëve që përfaqësojnë të paktën  $\frac{3}{4}$  e pjesëve të kapitalit themeltar.


**KAPITULLI III**  
**ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË DHE KOMPETENCAT E TYRE**

**NENI 9**  
**ORGANET DREJTUESE**

- 9.1 Organet drejtuese të shoqërisë janë:
- Asambleja e Përgjithshme
  - Administratori.

**NENI 10**  
**ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME, KOMPETENCAT E SAJ**

- 10.1 Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë drejtues i shoqërisë.
- 10.2 Asambleja e Përgjithshme drejton veprimtarinë e shoqërisë nëpërmjet marrjes së vendimeve. Vendimet që mund të marrë Asambleja e Përgjithshme përfshijnë kryesisht vendime për:
- Përcaktimin e politikave tregtare të Shoqërisë;
  - Ndryshimet në Statut;
  - Rritjen ose zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë;
  - Shitjen, transferimin dhe anulimin e kuotave të kapitalit themeltar;




- Emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- Emërimin dhe shkarkimin e Ekspertit kontabël dhe të likuidatorëve si dhe caktimin e shpërblimit të tyre.
- Mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, duke përfshirë edhe përgatitjen e pasqyrave financiare dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- Miratimin e pasqyrave financiare dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- Lëshimin e çertifikatës së aftësisë paguese të shoqërisë;
- Miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

## NENI 11 THIRRJA DHE ZHVILLIMI I MBLEDHJEVE

- 11.1** Asambleja e Përgjithshme mund të thirret në çdo kohë nga Administratori ose një apo disa ortakë që përfaqësojnë të paktën 5% (pesë përqind) të pjesëve të kapitalit themeltar. Mbledhja e zakonshme e Asamblesë së përgjithshme thirret të paktën 1(një) herë në vit, brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar për miratimin e bilancit, të raportit të Administratorit, ekspertit kontabël si dhe inventarit.
- 11.2** Mbledhjet zhvillohen në selinë e shoqërisë ose në çdo vend tjetër të njoftuar nga Administratori.
- 11.3** Njoftimi kryhet me shkrim ose me postë elektronike jo më vonë se 7 (shtatë) ditë përpara datës së zhvillimit të mbledhjes dhe përmban datën, vendin, orën dhe rendin e ditës së mbledhjes.

## NENI 12 MARRJA E VENDIMEVE

- 12.1** Asambleja e Përgjithshme, në rastin e marrjes së vendimeve që kërkojnë një shumicë të zakonshme, mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30% (tridhjetë përqind) të kuotave.
- 12.2** Vendimet e Asamblesë, për të cilat kërkohet një shumicë e kualifikuar, sipas përcaktimit të nenit 12, pika 3, të këtij Statuti, janë të vlefshme nëse janë të pranishëm në mbledhje ortakët që zotërojnë më shumë se 50% (pesëdhjetë përqind) të numrit total të votave.
- 12.3** Asambleja e Përgjithshme vendos me  $\frac{3}{4}$  e votave të ortakëve pjesëmarrës për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit, shpërndarjes së fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
- 12.4** Nëse Asambleja nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në nenin 12, pikat 1 dhe 2 të këtij Statuti, Asambleja do të mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.
- 12.5** Të gjitha vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal. Administratori përgjigjet për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme. Procesverbali nënshkruhet nga kryetari dhe mbajtësi i procesverbalit.

**NENI 13**  
**ADMINISTRATORI, TË DREJTAT DHE DETYRIMET E TIJ**

- 13.1 Administratori është organi ekzekutiv i shoqërisë.
- 13.2 Shoqëria do të administrohet nga Z. Mirel Mjekra I biri Kujtimit, lindur në datë 31.10.1988 në Tiranë e me banim në Tiranë, madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtësi i lehtënjofitimit me numër personal I81031048M,, madhor, me zotësi të plote juridike për të vepruar;
- 13.3 Administratori ka të drejtë e detyrohet:
- Të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme;
  - Të përfaqësojë shoqërinë tregtare në marrëdhëniet me të tretët personalisht ose duke caktuar zëvendësues;
  - Të kujdeset për mbajtjen e saktë dhe të rregullt të dokumenteve dhe librave kontabël të shoqërisë;
  - Të përgatisë dhe të nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë;
  - Të krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
  - Të kryejë regjistrimet dhe të dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, sipas parashikimeve të ligjit “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
  - Të raportojë para Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë.
- 13.4 Administratori emërohet për një periudhë 5 vjeçare me të drejtë ripërtëritjeje.

**KAPITULLI IV**  
**VITI FINANCIAR, BILANCI DHE FITIMET**

**NENI 14**  
**VITI FINANCIAR**

- 14.1 Viti financiar i shoqërisë përputhet me vitin kalendarik, duke filluar më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor.
- 14.2 Si përjashtim, viti i parë i veprimtarisë së shoqërisë do të fillojë nga dita e regjistrimit të shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dhe përfundon më 31 Dhjetor 2020.
- 14.3 Shoqëria përgjigjet për kontributin fiskal, afatet e derdhjes së tij, sigurimet shoqërore etj. Ajo ka të drejtë të çelë llogari likuiduese pranë bankave dhe të kryejë veprime likuiduese me to, brenda dhe jashtë vendit.
- 14.4 Llogaritë vjetore, inventarët, raportet mbi operacionet e vitit financiar miratohen nga Asambleja e Ortakëve të shoqërisë.



- 14.5 Miratimi i dokumenteve që lidhen me vitin financiar duhet të bëhet brenda 6 (gjashtë) muajve që nga fundi i vitit financiar.

## NENI 15 BILANCI. MBAJTJA E KONTABILITETIT

- 15.1 Bilanci vjetor i shoqërisë duhet të hartohet për t'iu paraqitur organeve tatimore deri në fund të muajit Mars të vitit pasardhës.
- 15.2 Kontabiliteti mbahet në gjuhën dhe në monedhën shqiptare. Shoqëria mund të ketë edhe llogari të veçanta në valutë të cilat do të konvertohen çdo muaj në monedhën shqiptare.
- 15.3 Pas shlyerjes së detyrimeve fiskale ndaj shtetit, fitimi neto mund të përdoret për zgjerimin e aktivitetit, për rritjen e kapitalit të shoqërisë ose i shpërndahet ortakëve sipas kuotave të zotëruara.


## NENI 16 FITIMET

- 16.1 Ortakët kanë të drejtë të ndajnë pjesën e fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë, në raport me kuotat që ata zotërojnë.
- 16.2 Të ardhurat që do të rezultojnë deri në fund të mbylljes së çdo viti ushtrimor, mund të ndahen ndërmjet ortakëve në raport me pjesët që ata zotërojnë në kapitalin e shoqërisë, vetëm nëse:
- Aktivet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj;
  - Shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.

## KAPITULLI V PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË. ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

### NENI 17 PRISHJA E SHOQËRISË

- 17.1 Shoqëria priset:
- në përfundim të afatit të parashikuar nga Statuti;
  - me vendim të Asamblesë së Përgjithshme;
  - me hapjen e procedurave të falimentimit;
  - me vendim të gjykatës.
- 17.2 Administratori do të regjistrojë vendimin për prishjen e shoqërisë, pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Tregtare të Regjistrimit". Në rast se prishja e shoqërisë bëhet me vendim gjykate, gjykata ia njofton vendimin Qendrës Kombëtare për Regjistrim.



6

**NENI 18**  
**LIKUIDIMI I SHOQËRISË**

- 18.1** Në rast prishjeje shoqëria duhet të likuidohet.
- 18.2** Për të administruar këtë procedurë, Asambleja e Ortakëve emëron një ose më shumë likuidatorë, të cilët paraqesin raporte përfundimtare mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetit të shoqërisë, mbi operacionet e likuidimit dhe mbi kohën e nevojshme për të përfunduar likuidimin.
- 18.3** Me përfundimin e procedurës së likuidimit, Asambleja vendos mbi bilancin financiar përfundimtar, mbi punën e kryer nga likuiduesit dhe mbi përfundimin e procesit të likuidimit.
- 18.4** Pas pagimit të kreditorëve dhe mbledhjes së kredive, likuidatori do t'i shpërndajë të ardhurat përfundimtare të likuidimit Ortakëve të shoqërisë, në proporcion me kuotat e kapitalit të zotëruara prej tyre.
- 18.5** Likuidatori/ët njoftojnë Qendrën Kombëtare të Regjistrimit për përfundimin e procesit të likuidimit duke kërkuar çregjistrimin e shoqërisë në përputhje me parashikimet e ligjit "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".


**NENI 19**  
**ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE**

- 19.1** Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e këtij Statuti, do të zgjidhen në mënyrë miqësore dhe do të diskutohen në mënyrë të drejtpërdrejtë ndërmjet palëve të interesuara.
- 19.2** Në rast se nuk arrihet në një zgjidhje të mosmarrëveshjeve me mirëkuptim, ato do t'i drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

**KAPITULLI VI**  
**DISPOZITA PËRFUNDIMTARE**

**NENI 20**

- 20.1** Ky statut është hartuar në përputhje me:
- i) Ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar;
  - ii) Ligjin Nr. 9723, datë 03/05/2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" i ndryshuar.
- 20.2** Për çështje që nuk janë shprehur plotësisht në këtë Statut, shoqëria i referohet Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar.


 7

20.3 Ky Statut, përbëhet nga 20 nene dhe u redaktua në 3 (tre) kopje identike në gjuhën shqipe, duke patur të gjitha fuqi të njëjtë ligjore.

## ORTAKËT

**MIREL MJEKRA**

MIREL MJEKRA



**SARA KORRESHI**

Sara Korreshi

